



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2019:095147  
Datë: 27.06.2019  
Numri i dokumentit: 00381983

C.nr.1123/18

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Ilir Berisha, në çështjen juridiko civile kontestimore të paditëses S. (V.) I., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit, V. M. avokat në Pejë, kundër të paditurit A. (V.) I., nga Peja, rr. baza juridike: revokim i dhuratës, vlera e kontestit 22,000 euro, jashtë seancës me datë 27.06.2019, bie këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**NË BAZË TË POHIMIT**

**I.REVOKOHET** kontrata mbi dhurimin e lidhur në mes të paditëses S. I. si dhurate dhënëse dhe M. I. si dhurate marres për pjesën ideale e të 1/8 të ngastrës kadastrale nr. P-7...1-01506-5 në sipërfaqe prej 400 m2, ZK. Pejë, me kulture tokë ndërtimore në sipërfaqe prej 290 m2 dhe shtepin – ndërtesë në sipërfaqe prej 110 m2, e lidhur me datë 26.12.2017 në Zyrën e Noterit A. A. në Pejë, me numër LRP. Nr. Rend. 7035/2017 dhe nr.R.1279/2017.

**II.DETYROHET** i padituri A. I. që paditëses S. I. tija kthej pjesën e patundshmërisë së dhuruar të cilën ja ka bartur me kontratën e dhurimit dhe të lejoj që e njëjta të regjistrohet si bashkëpronare në pjesën ideale e 1/8 së ngastrës kadastrale nr. 1506/5 ZK Pejë, në afat prej 15 ditësh nga dita e shpalljes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit.

**III.**Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

*Arsyetim*

Paditësi, me datë 16.10.2019, kishte ushtruar padi kundër të paditurit për revokimin e dhuratës, vlera e kontestit 22.000 euro. Padinë e kishin parashtruar në mënyrën si vijon: Me paditësja me paditësin janë motër dhe vëlla, dhe me datën 26.12.2017 kanë lidhur kontratë mbi dhuratën me nr. LRP.nr.rend:7035/2017 dhe nr.Ref.1279/2017 tek Noteri A. S. A. në Pejë, me të cilën kontratë, paditësja në cilësinë e dhuratëdhënëses së bashku me motrën e saj S. (V.) B., i dhurojnë vëllait të tyre A. I., pjesën e bashkëpronësisë që kanë në paluajtshmërinë me nr. të njësisë kadastrale P-...-01506-5, me sipërfaqe të përgjithshme prej 400m2, Zona Kadastrale Pejë, lloji i njësisë: Parcelë, shfrytëzim aktual: Tokë Ndërtimore/Oborr me sipërfaqe prej 290 m3 Tokë Ndërtimore/Shtëpi – Ndërtesë, me sipërfaqe prej 110 m2, pjesa e pronësisë: bashkëpronësi, 1/8 në emër të S. (V.) I. dhe 5/8 në emër të A. (V.) I. të trashëguara nga babi i tyre i ndjerë V. I..

Pas lidhjes së kontratës mbi dhurimin paditësja fillimisht ka qenë duke banuar tek motra e saj dhe kur ka dëshiruar të kthehet në shtëpinë që ka jetuar me herët sjelljet e dhuratëmarrësit dhe familjes së tij në raport me paditësen janë keqësuar. Me ç'rast i njëjti dhe familja e tij e kanë kundërshtuar kthimin e saj përsëri në shtëpi. E gjendur para kësaj shtate në mungesë të

mjeteve të mjaftueshme për të jetuar dhe pas sjelljeve jo mirënjohëse nga familjaret e paditësit, paditësja ka kërkuar që të revokohet pjesa e saj e dhuratës në mënyrë që të sigurojë një vend për të jetuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

I padituri nuk ka dhënë përgjigje në padi mirë po në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar së nuk e kontestoj kërkesëpadinë e paditëses pasi që e njëjta është e bazuar edhe pse këtë dhuratë unë motrës nuk ja kam kërkuar. Andaj edhe tani pajtohem që të njëjtën t'ia kthej sepse është pasuri e saj. Mire po ne kemi pasur si synim që këtë patundshmëri t'ia japim për ndërtim një investitori që në ato hapësira të ndërtoj objekt afarist dhe banesor, e si kompensim të marrim disa banesa në mënyrë që të rregullohet edhe çështja e banimit të motrës time.

Pasi që i padituri në seancën e datës 07.06.2019 në tërësi e ka pohuar kërkesëpadinë e paditësve, gjykata duke u mbështetur në dispozitën ligjore nga neni 148.1 të LPK-së, e cila shprehimisht parasheh se: *“Në çoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë”*, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Deri në këtë përfundim gjykata arriti pasi u bind së në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me kërkesa me të cilat palët nuk mund të disponojnë të përcaktuara me nenin 3.3 të LPK-së.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata ka vendosur duke u bazuar në nenin 463.1 të LPK, meqenëse asnjëra nga palët nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- Departamenti i Përgjithshëm, me dt.27.06.2019

Gj y q t a r i  
Ilir Berisha

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Pala e pakënaqur ka të drejtën e ankesës në afat prej 15 ditëve në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.